



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:221505

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05382397

P.nr.670/22

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona Lajqi, me bashkëpunëtoren profesionale Medina Rama, në çështjen penale kundër të pandehurit: U. S., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2011/22 e datës 26.10.2022, jashtë seancës, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në mbështetje të nenit 357 par.1 pika 1.3 e lidhur me nenin 441 par.4 të KPP-së, me datën 27.02.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2011/22 e datës 26.10.2022 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit: U. S., nga i ati Sh., e ëma E., i lindur me datë ..., në Mitrovicë ku edhe tani jeton në rrugën "...", me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, për shkak të mos plotësimit dhe korigjimit të aktakuzës nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.
- II. Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.
- III. Pala e dëmtuar Kompania Rajonale e Ujësjellësit Mitrovicë për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2011/22 të datës 26.10.2022, kundër të pandehurit: U. S., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me datë 07.04.2023, i është drejtuar Prokurorisë Themelore në Mitrovicë lidhur me kthimin e Aktakuzës PP.II.nr.2011/22 të datës 26.10.2022 në plotësim dhe korrigjim, në të cilën ka theksuar se Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me rastin e ngritjes së aktakuzës nuk i ka dhënë mundësinë fare të pandehurit që të deklarohet në procedurën penale para se të ngritet aktakuza, e drejtë kjo e përcaktuar me nenin 149 paragrafi 1 të KPP-së, duke marrë parasysh faktin se vepra për të cilën akuzohet i pandehuri dënohet deri në 3 vjet burgim. Andaj padyshim se aktakuza nuk mund të ngritet pa e dëgjuar edhe të pandehurin siç përcakton dispozita e nenit 149 të KPP-së, apo i pandehuri të jetë marrë në pyetje në polici me autorizim të prokurorit të shtetit. Gjykata ka vlerësuar se kjo aktakuzë, si e tillë nuk i plotëson kriteret dhe standardet minimale të një akti akuzues. Kur kemi parasysh faktin se nuk janë zbatuar standardet e garantuara me këtë kod në raport me të drejtat e të pandehurve në procedurë penale, andaj ka vlerësuar se nuk mund të procedojmë në asnjë fazë të mëtejme të procedurës penale me këtë aktakuzë. Prandaj, në kuptim të nenit 441 gjykata e ka obliguar Prokurorinë Themelore në Mitrovicë që në afat prej tridhjetë (30) ditëve, të ndërmerr veprimet e nevojshme sipas udhëzimeve të gjykatës me qëllim që të procedohet tutje në këtë çështje penale. në të kundërtën, nëse brenda afatit të cekur nuk e plotëson apo korigjon aktakuzën sipas udhëzimeve të gjykatës, gjykata do të veprojë sipas nenit 441 par.4 të KPP-së.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me datë 28.04.2023, e ka njoftuar këtë gjykatë se duke vepruar sipas kërkesës së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Prokuroria e ka autorizuar policinë e Kosovës për marrjen në pyetje të të pandehurit U. S. në drejtim të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 të KPRK-së, mirëpo nga raporti policor theksohet se tani i pandehuri U. S. nuk gjendet në shtetin e Kosovës, andaj ka kërkuar nga Gjykata t'i jep një afat shtesë për sigurimin e deklaratës së të pandehurit.

Gjykata Themelore në Mitrovicë me datën 16.05.2023 e ka njoftuar Prokurorinë Themelore në Mitrovicë se në kuptim të nenit 441 të KPP-së, obligohen që brenda afatit shtesë prej njëzet (20) ditëve, të ndërmarrin veprimet e nevojshme të përcaktuara në parashtrësën e Gjykatës së datës

07.04.2023, në të kundërtën, nëse brenda afatit shtesë të cekur nuk e plotësojnë apo korigjojnë aktakuzën sipas udhëzimeve të kësaj gjykata, e njëjta do të hedhet, sipas paralajmërimeve në shkresën paraprahe.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me datën 18.05.2023, i është drejtuar Gjykatës Themelore në Mitrovicë me njoftim duke theksuar se plotësimi i aktakuzës në afat prej njëzet (20) ditëve e ka të pamundur për faktin se për momentin Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie është duke funksionuar vetëm me një prokuror, pastaj nga shkresat e lëndës shihet se tani i pandehuri gjendet jashtë vendit, andaj në këtë kuptim e ka të pa mundur plotësimin e aktakuzës siç ka kërkuar gjykata.

Megjithatë, në këtë drejtim, për këtë Gjykatë është tërësisht irelevante fakti se cilat mjete, mënyra apo metoda prokuroria i zbaton për kryerjen e obligimeve të saj ligjore, sikurse edhe fakti nëse organet e tjera kanë vepruar apo jo sipas autorizimit apo kërkesës së prokurorit. Kjo është një çështje e brendshme, ku prokurori ka gjithë autorizimet ligjore të veprorj në çdo rast kur urdhërat e tij nuk zbatohen.

Gjykata, pasi që ka shqyrtuar Kërkesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për rastin konkret dhe përgjigjen ndaj parashtresës së kësaj Gjykate, gjeti se aktakuza nuk është plotësuar/ndryshuar nga ana e Prokurorisë siç është kërkuar nga ana e Gjykatës në parashtresën e datës 07.04.2023.

Gjykata vlerëson se prokuroria, në përgjigjen e saj ndaj parashtresës së kësaj Gjykate, ka theksuar se i nevojitet afat shtesë në mënyrë që të veprohet sipas kërkesës së gjykatës, mirëpo gjykata duke marr parasysh faktin se që nga momenti i parashtresës së Gjykatës Themelore në Mitrovicë për përmirësimin apo korigjimin e aktakuzës nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë e deri më sot kanë kaluar më shumë se dhjetë (10) muaj dhe kjo periudhë kohore ka qenë e mjaftueshme për përmirësimin apo korigjimin e aktakuzës nga ana e kësaj prokurorie.

Gjykata në këtë rast iu ka referuar edhe praktikës së Gjykatës së Apelit, ku në një rast, respektivisht në rastin PN.nr.1005/20, e ka refuzuar ankesën e prokurorisë duke e vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, datë 27.11.2020, me të cilin Aktvendim ishte hudhur aktakuza e prokurorisë për shkak të mosplotësimit të aktakuzës nga prokurori i shtetit,

në lidhje me marrjen e deklaratës nga i pandehuri, ku edhe Gjykata e Apelit ka konstatuar se aktakuza në këtë rast është ngritur në kundërshtim me nenin 241, të Kodi Nr. 04/L-123 i procedurës penale- pasi që të pandehurit nuk i është dhënë mundësia që të dëgjohet në procedurë para ngritjes së aktakuzës. Gjithashtu, në një rast pothuajse tërësisht të ngjashëm, Gjykata e Apelit me Aktvendimin PN.nr.1090/2021, datë 21.01.2022, e ka refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe e ka vërtetuar Aktvendimin P.nr.370/2021, datë 20.08.2021, në të cilin rast ishte hudhur aktakuza për arsyen se prokurori i shtetit nuk kishte vepruar sipas kërkesës së Gjykatës për plotësimin e aktakuzës, për arsyet e njëjta, pra për faktin se prokuroria nuk ka vepruar sipas kërkesës së gjykatës për plotësimin e aktakuzës.

Andaj, duke qenë se Prokuroria ende nuk ka marr ndonjë veprim në lidhje me kërkesën e Gjykatës, konform nenit 441 paragrafi 4 ku përcakton se *“gjykata thërret paraqitësin e parashtrësës së pakuptueshme ose që nuk përmban atë që është e nevojshme që të mund të veprohet në bazë të saj, që ta korrigjoj apo ta plotësojë parashtrësën, e nëse ai nuk e bën këtë brenda afatit të caktuar, gjykata e hedh poshtë”*, gjykata vendosi që të hedhë poshtë aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë si dhe ta pushoj procedurën penale ndaj të pandehurit, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në këtë çështje e ka hedhur poshtë aktakuzën si të pa plotësuar dhe të pa korrigjuar, që nënkupton se prokurori i shtetit mund të parashtroj aktakuzë pas plotësimeve dhe korrigjimeve të nevojshme që duhet të përmbajë aktakuza.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 462 par. 3, të KPP-së.

Andaj, në bazë të lartcekurave e në kuptim të nenit 357 dhe nenit 441 par.4 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr.670/22 datë 27.02.2024

Gj y q t a r j a
Marigona LAJQI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë e personave të autorizuar në afat prej 3 ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Numri i lëndës: 2022:221505
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05382397